

VENDIM
Nr.183, datë 9.2.2011

**PËR KOMPENSIMIN PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET QË I SHKAKTOHEN
PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS
DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të vet, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:

- a) Nga 36 km deri 60 km, në masën 3 000 lekë/muaj;
- b) nga 61 km deri 100 km, në masën 5 000 lekë/muaj;
- c) nga 101 km deri 150 km, në masën 8 000 lekë/muaj;
- ç) nga 151 km deri 200 km, në masën 10 000 lekë/muaj;
- d) mbi 200 km, në masën 15 000 lekë/muaj.

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të policisë, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin e juridiksionit të komisarariatit të policisë apo drejtorisë së policisë së qarkut (në rrethin qendër qarku), ku punonjësi i policisë është transferuar.

2. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në organin, ku është transferuar, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesë me shkrim, me gjenealogjetet e plota, ku përshkruhet:

- organi ku ka punuar;
- data e transferimit;
- motivi i transferimit;
- adresa ku banon aktualisht familja e tij;
- adresa ku banon përkohësisht vetë punonjësi.

b) Fotokopje të kartës së identitetit, certifikatë të gjendjes civile, personale dhe familjare.

c) vërtetim nga komuna/njësia bashkiake/bashkia, ku të vërtetohet vendbanimi i familjes dhe i vetë punonjësit të policisë, pavarësisht nga gjendja civile.

3. Kur punonjësi i policisë transferohet për nevoja pune dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i humbet marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

a) 50% të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ku bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 muaj deri në 1 vit.

b) 100% të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 vit deri në 10 vjet.

c) 100% të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150% e pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indekssohet me rritjen e pagave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/it të punonjësit të policisë, deri në 15 vjet, në rastet kur në vendbanimin përkatës nuk ekzistojnë mundësi punësimi, llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme të punës për efekt pensioni. Kontributi i sigurimeve derdhet nga institucioni dhe përfituesi sipas skemës së sigurimeve shoqërore për punonjësit civilë.

4. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në

organin, ku është transferuar, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesë me shkrim, me gjenealogjet e plotë, ku përshkruhet:

- organi ku ka punuar;
- data e transferimit;
- arsyeja e transferimit;
- adresa ku ka banuar;
- adresa aktuale ku banon pas transferimit;
- qendra e punës ku ka punuar bashkëshortja/i, data dhe shkaku i largimit nga puna.

b) Librezën e punës të bashkëshortes/it, ku të jetë cilësuar largimi nga puna për arsye të transferimit të bashkëshortes/it.

c) Vërtetim nga zyra përkatëse e punësimit, ku të vërtetohet se bashkëshortja/i është regjistruar si punëkërkuar i papunë dhe nuk i është ofruar punë në profesionin e saj/tij. Këtë vërtetim punonjësi e paraqet çdo tre muaj në zyrën e personelit.

5. Punonjësi i policisë, në përpjesëtim me kohën e shpenzuar gjatë ushtrimit të detyrës shtesë të trajnuesit në terren të punonjësve të policisë që kanë përfunduar periudhën e shkollimit në shkollën bazë të policisë, përfiton shtesë mbi pagën mujore në masën 40 lekë/orë, por jo më shumë se 7000 (shtatë mijë) lekë.

6. Përveç të drejtës për shpërblim në fund të vitit financiar, parashikuar në pikën 5 të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2010 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësit të Policisë së Shtetit, në kompensim të privacioneve dhe humbjeve që i krijohen për shkak të kryerjes së detyrave e shërbimeve të veçanta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit e të gatishmërisë, ruajtjen e administrimit e pronës dhe në ushtrimin e përgjegjësisë të tjera të parashikuara me ligjin për Policinë e Shtetit, mund t’i jepet shpërblim deri në 1 (një) pagë mujore në vit. Ky shpërblim përballohet nga fondi i veçantë dhe mund të jepet përgjatë gjithë vitit kalendarik. Masa e shpërblimit përcaktohet dhe jepet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

7. Punonjësi i policisë, që përfiton sipas pikave 1 e 3 të këtij vendimi, nënkupton punonjësin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 11 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, duke mos përfshirë punonjësin e emëruar për herë të parë, por vetëm atë efektiv.

8. Vendimi nr.507, datë 18.7.2003 i Këshillit të Ministrave “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Policisë së Shtetit.

10. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha